



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA NË SKENDERAJ

Numri i lëndës: 2021:013927

Datë: 14.06.2021

Numri i dokumentit: 01879574

P.nr.10/2021

NË EMËR TË POPULLIT

- **GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË SKENDERAJ, Departamenti i Përgjithshëm**, me gjyqtarin e vetëm gjykues Fatos Sejdiqaj dhe procesmbajtësen Florije Gucati, duke vendosur në çështjen penale ndaj të akuzuarit R., V., nga fsh.... Rr."...", Komuna Skenderaj, për shkak të veprës penale-Sulmi nga neni 184 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës Nr.06/L-074 (tutje:KPRK), i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë-Departamenti i Përgjithshëm PP-II.nr.149/2021, të datës 25.01.2021 (2021:0004565), duke vendosur lidhur me kërkesën për dhënien e urdhrin ndëshkimor pa mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor, me datën 14.06.2021, mori këtë :

A K T G J Y K I M

- **PRANOHET** kërkesa e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë-Departamenti i Përgjithshëm PP-II.nr.149/2021, të datës 11.06.2021 dhe gjykata e jepë këtë :

U R D H Ë R N D Ë S H K I M O R

- **I akuzuari R., V.,** nga babai ... dhe nëna ..., mbiemri i vajzërisë ..., i lindur me datë (data e lindjes) në ...-Komuna Skenderaj, ku edhe tani jeton, me numër personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka të kryer shkollën e mesme, i martuar, i gjendjes së mesme ekonomike.

Ë S H T Ë F A J T O R

- **SEPSE** : Me datë ... rreth orës ... në rrugën ".... në fshatin Komuna Skenderaj, i pandehuri R., V., me dashje përdorë forcën ndaj të dëmtuarës K., V., ashtu që deri sa e dëmtuara ishte duke shëtitur me biçikletë rrëzohet dhe aksidentalisht ia gërvish veturën e tipit të pandehurit R., V., i cili fillimisht fillon t'i bërtas të dëmtuares ... dhe pastaj i pandehuri, e godet me shuplakë në pjesën e djathtë të fytyrës.

- **Me këtë ka kryer veprën penale-Sulmi nga neni 184 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).**

- Andaj, gjykata në bazë të kësaj dispozite ligjore e lidhur me nenet : 4, 38, 43, 69 dhe 70 të KPRK-së, si dhe nenit 365, 450 par.1 dhe par.2 nënpar.2.6, nenit 453 par.1, nenit 463 par.1 dhe 2, nenit 495 par.1 dhe 2 të KPP-së, të akuzuarit i shqipton :

- D Ë N I M M E G J O B Ë -

I.- Në lartësi prej 250.00 € (dyqindë e pesëdhjetë euro) të cilën shumë është i obliguar që ta paguajë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh prej ditës së plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

II.- Nëse i akuzuari dënimin e shqiptuar me gjobë nuk e paguan në afatin e përcaktuar nga gjykata, atëherë dënimin e shqiptuar me gjobë në bazë të nenit 43 par.3 të KPRK-së do ta zëvendësojë me dënim me burgim, ashtu që një (1) ditë burgim do të llogaritet me njëzetë (20.00) Euro gjobë.

III.- Obligohet i akuzuari që t'i paguajë shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të kësaj gjykate, në emër të paushallit gjyqësor shumë prej njëzetë (20.00) Euro si dhe në emër të kompensimit të viktimave të krimit shumë prej tridhjetë (30.00) Euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

IV.- Pala e dëmtuar me adresë vendbanimi nëRr."....."-Skenderaj, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

A r s y e t i m

- Prokuroria Themelore në Mitrovicë-Departamenti i Përgjithshëm ka paraqitur aktakuzën e saj PP-II.nr.149/2020 të datës, kundër të akuzuarit R., V., nga fsh....-Komuna Skenderaj, për shkak të veprës penale-Sulmi nga neni 184 par.1 të KPRK-së dhe në bazë të nenit 493 par.1 dhe 2 të KPP-së, ka kërkuar nga gjykata që të akuzuarit t'i shqiptoj urdhrin ndëshkimor-dënim me gjobë pa e mbajtur shqyrtimin gjyqësor, me arsyetimin se janë siguruar prova të besueshme se i akuzuari ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

- Gjkata me rastin e shqyrtimit paraprak të aktakuzës dhe kërkesës për dhënien e urdhrin ndëshkimor, gjeti se janë plotësuar kushtet ligjore për dhënien e urdhërit ndëshkimor në kuptim të nenit 495 të KPPK-së.

- Gjkata vlerësoi se në shkresat e lëndës ekzistojnë prova të besueshme për dhënien e urdhrin ndëshkimor të cilat e vërtetojnë faktin se i akuzuari ka kryer veprën penale në fjalë si : Kallëzimi penal i Policisë së Kosovës-Stacioni Policor në Skenderaj Nr..... i datës, Raporti i oficerit policor-.... Nr..... i datës, Procesverbali mbi marrjen në pyetje të dëmtuarit-Nr..... i datës dhënë në Policinë e Kosovës-Stacioni Policor në Skenderaj, Procesverbali mbi marrjen në pyetje të akuzuarit Nr..... i datës 10.11.2020 dhënë në Policinë e Kosovës-Stacioni Policor në Skenderaj si dhe foto dokumentacioni dhe shkresat e tjera të

lëndës, gjykata të njëjtin e shpalli fajtor dhe i shqiptoi dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

- Gjukata duke u bazuar në këto prova të besueshme vërtetoi se me veprimet inkriminuese të të akuzuarit përmbushen të gjitha elementet e veprës penale-**Sulmi nga neni 184 par.1 të KPRK-së**, ngase i njëjti me datë rreth orës ... në rrugën “ në fshatin Komuna Skenderaj, i pandehuri R., V., me dashje përdorë forcën ndaj të dëmtuarës, ashtu që deri sa e dëmtuara ishte duke shëtitur me biçikletë rrëzohet dhe aksidentalisht ia gërvish veturën e tipit të pandehurit R., V., i cili fillimisht fillon t’i bërtas të dëmtuares ... vjeçe dhe pastaj i pandehuri, e godet me shuplakë në pjesën e djathtë të fytyrës, për çka gjykata gjeti se i akuzuari në aspektin penal-juridik është përgjegjës dhe i shqiptojë dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

- Me rastin e marrjes se vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit, gjykata mori parasysh dhe vlerësoi të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara në nenin 69 dhe 70 të KPRK-së, e në rastin konkret për të njëjtin rrethanë lehtësuese gjeti rrethanat e tij personale, ndërsa rrethanë rënduese në rastin konkret gjeti shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit si dhe moshën e viktimës-të dëmtuarës së mitur andaj, duke u bazuar në rrethanat rënduese dhe lehtësuese të cekura si më lartë gjykata të akuzuarit i shqiptojë dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke pritur me të drejtë se me dënimin e shqiptuar do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë sipas nenit 38 të KPRK-së, që të parandalojë kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave të tilla penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

- Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësor, gjykata e mori duke u bazuar në nenet 450 par.1 dhe 2 pika 2.6 dhe nenin 453 par. 1 të KPP-së, ndërsa vendimi për kompensimin e viktimave të krimit u morë në bazë të nenit 39 par.3 pika 3.1 të Ligjit Nr.05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

- Në këtë çështje penale në bazë të shkresave të lëndës gjykata ka gjetur se palë e dëmtuar është Klea Veliu dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi ashtu që, vendimi mbi udhëzimin e palës së dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike në kontest civil është marrë konform nenit 463 par.1 dhe 2 të KPP-së.

- Nga sa u tha më lartë e në kuptim të nenit 365 dhe nenit 495 të KPP-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË SKENDERAJ

**- Departamenti i Përgjithshëm -
P.nr.10/2021 me datë 14.06.2021.**

**Procesmbajtësja,
Florije Gucati**

**Gjyqtari i vetëm gjykues,
Fatos Sejdiqaj**

- **KËSHILLA JURIDIKE** : Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet kundërshtim në afat prej 8 (tetë) ditëve nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi. Kundërshtimi i drejtohet kësaj Gjykate me shkrim apo me gojë në procesverbal të kësaj gjykate. Nëse i akuzuari në afatin prej 8 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nuk ushtron kundërshtim, ky aktgjykim do të merr formën e prerë dhe do të ekzekutohet.